REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 2707 Prot.

Lushnje,më 17/03/2026

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK
MBI NJË SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2026
NGA TË ARDHURAT E TRASHËGUARA
(Miratuar me VKB nr.122 datë 23.12.2025)

Të nderuar zonja dhe zotërinj këshilltar!

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" sipas Nenit 61/1 "Përdorim i fondeve të trasheguara nga viti i kaluar", Ligjin Nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", Udhëzimi Nr. 2 datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026", Udhëzimit Nr. 9 datë 20.03.2018 "Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit", si dhe mbas rakordimit të ardhurave të trashëguara nga viti 2025 për në vitin 2026 nga të cilat 285,000,000 lekë janë miratuar dhe shpërndarë në buxhetin e vitit 2026 si dhe shtesa në buxhet nga të ardhurat e trashëguara sipas VKB nr 13 datë 22.01.2026 me vlerë 24,014,201 lekë, VKB nr 14 datë 22.01.2026 në vlerë 3,056179.78 lekë nga kapitulli 01 dhe 3,777,716.84 lekë me kapitull 02. Pas këtyre shpërndarjeve kemi ende fonde të pashpërndara nga kapitulli 01 dhe 05.

Nisur nga kërkesa e disa drejtues programesh, pas diskutimeve në mbledhjen e GMS-së, u vendos të bëjmë një shtesë në buxhetin e vitit 2026 në disa programe buxhetore për këto arsye:

1. Sipas Kontrates nr. 831 dt 29.01.2024 per objektin "Rindërtim i shkollës 9 - vjeçare "Irakli Bozo" Golem" në vleren 30,536,684.40 lekë me operator ekonomik Nika Shpk, nuk u arrit të likujdohej gjatë vitit 2025. Ky investim ishte në buxhetin e vitit 2024 dhe 2025. Për porblematika të sistemit të Platformës Qëndrore të Faturave të Administratës Tatimore subjekti nuk arriti të lëshonte faturën tatimore brenda afateve në fund të vitit 2025. Në buxhetin e vitit 2026 u parashikua që të likujdohej 10,000,000 lekë pasi pjesa tjetër do të likujdohej në periudhën dhjetor 2025-janar 2026 me fondet e dhjetor 2025 sipas udhezimit nr 127 datë 19.12.2025 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për Vitin 2025" sipas të cilit brenda datës 27.01.2026 përfundon paraqitja dhe regjistrimi në SIFQ i shpenzimeve për vitin 2025. Keto fonde te papërdorura u trashëguan për vitin 2026 dhe po i shpërndajmë në të njejtin destinacion nga i cili u trasheguan për diferencen e paparashikuar në buxhetin e vitit

Adresa: Lagja Kongresi i Lushnjes Tel: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

2026 (*fonde të trasheguara të angazhuara sipas ligjit nr 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" sipas Nenit 61/1 "Përdorim i fondeve të trashëguara nga viti i kaluar"*).

- **Të shtohet Buxheti i Bashkisë per vitin 2026 me 20,536,685 lekë për objektin Rindërtim i shkollës 9 - vjeçare "Irakli Bozo" Golem" në Programin AE129-00-01-231- P912AAE.**

2. Të bëhet shtesa në programin në programin AB 129 "Shërbimet Publike Komunitare" artikulli 231 në Bashkinë Lushnje, për projektin me objekt "Rikalifikim i Rruges Misto Mame" në vlerë 130,000,000 lekë (AB129-00-01-231). Bazuar në dëgjesat publike për hartimin e buxhetit të vitit 2026 si dhe në diskutimet e Grupit të Menaxhimit Strategjik, ky projekt investimi është shume i rëndesishem për zhvillimin e zonës. (pas miratimit të projektit në Keshillin Bashkiak do bëhet celja e kodit të projektit për Degën e Thesarit)

   - **Të shtohet Buxheti i Bashkisë per vitin 2026 me 130,000,000 lekë për objektin "Rikalifikim i Rruges Misto Mame" në Programin AB129-00-01-231**

3. Të bëhet shtesa në programin AA129 "Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse" në produktin V111AAD ,V328 AAC për artikullin 00-01-602 në vlerën 3,000,000 lekë. Shtesa pwr keto produkt do të shperndahet në këto zera: a)shpenzime Keshilli Bashkiak, b) të tjera shpenzime materjale, c) projekte me bashkë-financim. Këto të ardhura jenë trashëguar në këto kode dhe po rishperndahen me të njëjtin destinacion.

   - **Të shtohet Buxheti i Bashkisë per vitin 2026 me 2,000,000 lekë në Programin AA129-00-01-602- V111AAD.**

   - **Të shtohet Buxheti i Bashkisë per vitin 2026 me 1,000,000 lekë në Programin AA129-00-01-602- V328 AAC.**

4. Të bëhet shtesa në programin AA129 "Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse" në produktin "Blerje Pajisje & Invest.tjera Bashkia" P111AAB për artikullin 00-01-231 në vlerën 1,000,000 lekë kjo për arsye të software-ve të avancuara të cilet po na sjellin vështiresi në funsionimin e disa prej pajisjeve elektronike (kompjutera) si dhe nevojës per pajisje të tjera shtesë.

   - **Të shtohet Buxheti i Bashkisë per vitin 2026 me 1,000,000 lekë në Programin AA129-00-01-231- P111AAB.**

5. Në programin AB 129 "Shërbimet Publike Komunitare" artikulli 602 në Ndërmarjen e Pasurisë Publike të shtohet buxheti me 20,000,000 lekë V452AAB "Rrjet Rrugor Rural i mirëmbajtur". Bazuar ë vendim këshillit Bashkiak nr.96 datë 29.09.2025, dërguar me shkresë nr.8932 datë 09.10.2025 pranë Ndërmarjes së Pasurise Publike, nuk u bë e mundur realizimi i procedurave të prokurimit brenda vitit buxhetor 2025. Këto fonde nuk u riparashikuan në buxhetin e vitit 2026 dhe u trasheguan me të ardhurat e trasheguara nga viti 2025. Për këtë arsye këto fonde po rishpërndahen me të njëjtin destinacion për përfundimin e procedurës për vitin 2026 (*fonde të trasheguara të paangazhuara sipas ligjit nr 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" sipas Nenit 61/1 "Përdorim i fondeve të trashëguara nga viti i kaluar"* por të planifikuara në

buxhetin e vitit 2025). Këtu do të bëheshin nderhyrje në shtrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve në zonat kodrinore dhe rruget e varrezave të fshatrave me shtresa betoni si më poshtë:

a) Degëzimi i rrugës "Pasho Zoto" (me gjatësi 80 ml dhe gjerësi 3m)
b) Rruga e "Varrezave" në fshatin Golem i Madh (me gjatësi 490 ml gjerësi 3m)
c) Rruga e "Varrezave Hajdaraj+ përballë" (me gjatësi 320 ml gjerësi 3m)
d) Rruga Cameria "Hilet" në Kolonjë (me gjatësi 120 ml gjerësi 3m)
e) Rruga e "Varrezave" në Karbunarë e Vogel (me gjatësi 350 ml gjerësi 3m)
f) Rruga "Demirasi" në fshatin Hysgjokaj (me gjatësi 370 ml gjerësi 3m)
g) Rruga "Hoxhallinjeve" në fshatin Gramsh (me gjatësi 400 ml gjerësi 3m)
h) Rruga e "Vidhes" në fshatin Zhamë (me gjatësi 400 ml gjerësi 3m)
i) Rruga "Teki Libohova" (me gjatësi 165 ml gjerësi 3m)
j) Rruga "Migjeni" (me gjatësi 100 ml gjerësi 3m)
k) Rruga "Sef Hoxhaj" në fshatin Allprenaj (me gjatësi 350 gjerësi 3m)
Sqaruar te relacinoni i .....

- Të shtohet Buxheti në Ndërmarrjen së Pasurisë Publike me **20,000,000 lekë** në programin AB129 në "Rrjet Rrugor Rural i mirëmbajtur" në produktin V452AAB-00-01-602

6. Në Buxhetin e vitit 2025 në investimet afatgjata materiale për Ndermarjen e Pasurise Publike u parashikua blerje mjeti eskavator. Gjatë këtij viti buxhetor është zhvilluar procedura e prokurimit me Urdhër Kerkesë Blerje Nr.16 datë 25.09.2025 për blerjen e mjetit Eskavator, por për shkak të vonesave në procedurë dhe afateve të ankimimit nuk u bë e mundur lidhja e kontratës brenda vitit 2025. Kontrata me operatorin është lidhur në vitin 2026 me kontratë nr. 66 prot datë 13.01.2026. Këto fonde të buxhetit të vitit 2025 u trashëguan dhe nuk u parashikuan në buxhetin e vitit 2026. Për këtë arsye do të rishperndahen me të njejtin destinacion nga i cili u trasheguan, pra në programin AB129 në projektin e investimit P424AAB-00-01-231 në vlerën 7,000,000 lekë për vazhdimin e prcedurës dhe likujdimin e operatorit (fonde të trasheguara të angazhuara sipas ligjit nr 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" sipas Nenit 61/1 "Përdorim i fondeve të trashëguara nga viti i kaluar").

- **Të shtohet Buxheti në Ndërmarrjen e Pasurisë Publike me 7,000,000 lekë në programin AB129 në "Blerje mjeti eskavator" në projektin P424AAB-00-01-231**

7. Bazuar në VKB nr 12 date 22.01.2026 "Mbi një ndryshim të VKB-së nr 121 datë 23.12.2025 "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të bashkisë, institucioneve në varësi dhe të njësive Administrative për vitin 2026 " si dhe VKB nr 20 date 26.02.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB-121 datë 23.12.2025" "Për miratimin e Nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Lushnje, institucioneve në varësi dhe të njësive administrative për vitin 2026", Vendimit Nr. 776, datë 19.12.2025. Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", VKM nr 104 datë 11.02.2026, "Për një ndryshim të VKM-së 419 datë 26.06.2024 "Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto të punonjësve të Shërbimit të

Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit"; VKM-së nr 103 datë 11.02.2026, "Për disa ndryshime në VKM-në nr 328 datë 31.05.2023", "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar; VKM-së nr 425 datë 26.06.2024, Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjesve të tjerë jomësimor dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar", përkatesisht lidhjet nr 3 dhe 4; VKM -së nr 87 datë 06.02.2026, "Për disa ndryshime në VKM-në nr 326 date 31.5.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar nepermjet te ciles efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2026, përballohen nga transferta e akorduar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, miratuar në ligjin nr.87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", si dhe nga të ardhurat e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore, kërkohet të bëhet shtesë në buxhetin e Ndërmarjes së pasurise Publike në Programin AB129 në produktin "Sherbimi i stafit të ndërmarrjeve publike të gjelberimit, varrezave" V626AAA-00-05 në vlerën 679,315 leke dhe 2,500,000 lekë në produktin V626AAA-00-01 per mbulimin e pagave dhe sigurmeve për efekt të rritjes sipas VKM dhe VKB të mësiperme:

- Të shtohet Buxheti ne Ndërmarrjen se Pasurise Publike me 3,179,315 lekë për paga dhe sigurime në programin AB129 në "Shërbimet Publike Komunitare" në produktin "Sherbimi i stafit të ndërmarrjeve publike të gjelberimit, varrezave" V626AAA nga të cilat 679,315 lekë AB129 në produktin V626AAA-00-05 dhe 2,500,000 lekë në produktin V626AAA-00-01

8. Në programin AB 129 "Shërbimet Publike Komunitare" artikulli 602 në Ndërmarjen e Pasurisë Publike të shtohet buxheti me 3,000,000 lekë programin V452AAC-00-01-602 per mirmbajtjen e mjeteve të punës dhe mjeteve të transportit të mbetjeve. Institucioni disponon një numër të konsiderueshëm mjetesh, një pjesë e të cilave janë të amortizuara dhe të vjetra. Duke qenë se këto mjete përdoren çdo ditë në terrene pune, ato pësojnë shpesh dëmtime dhe kërkojnë vazhdimisht pjesë këmbimi dhe mirëmbajtje, të cilat kanë kosto të konsiderueshme. Për këtë arsye kërkohet një shtesë fondi në vlerën 3,000,000 lekë.

- **Të shtohet Buxheti ne Ndërmarrjen se Pasurise Publike në programin AB129 në "Shërbimet Publike Komunitare" në produktin V452AAC-00-01-602 në vlerën 3,000,000 lekë.**

9. Në programin AB 129 "Shërbimet Publike Komunitare" artikulli 602 në Ndërmarjen e Pasurisë Publike të shtohet buxheti me 22,300,000 lekë për procedurën e prokurimit me Urdhër Kërkesë Blerje Nr.19 datë 30.09.2025 me objekt "Asfaltim i rrugëve në territorin e Bashkisë Lushnje". Prpcedure e cila ishte planifikuar të përfundonte në vitin 2025.Këto fonde të papërdorura gjatë vitit 2025 nuk u riparashukuan gjatë hartimit të buxhetit të vitit 2026 pasi pritej që kontrata të likujdohej brenda vitit 2025. Për këtë arsye kërkohet shperndarja e fondeve nga të ardhurat e

trashëguara nga vitit 2025, me qëllim finalizimin dhe likujdimin e kontratës(*fonde të trasheguara të angazhuara sipas ligjit nr 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" sipas Nenit 61/1 "Përdorim i fondeve të trashëguara nga viti i kaluar").*

- **Të shtohet Buxheti në Ndërmarrjen e Pasurisë Publike në programin AB129 në "Shërbimet Publike Komunitare" në produktin V452AAB-00-01-602 në vlerën 22,300,000 lekë.**

10. Në programin AB 129 "Shërbimet Publike Komunitare" artikulli 602 në Ndërmarjen e Pasurisë Publike të shtohet buxheti me 4,140,000 lekë për procedurë e prokurimit me objekt "Blerje materiale çakull dhe stabilizant për investime në infrastukturën rrugore". Kontrata me nr 1645 prot datë 29.12.2025 lidhur me operatorin nuk arriti tw finalizohej nw vitin 2025 dhe nuk u parashikua në buxhetin e vitit 2026 dhe për rrjedhojë këto fonde u trashëguan në të ardhurat e trashëguara të vitit 2025. Për të vazhduar me zbatimin dhe likujdimin e kësaj kontrate kërkojmë të shtojmë buxhetin e vitit 2026 duke shpërndarë këto të ardhura me të njëjtin destinacion nga i cili u trasheguan (*fonde të trasheguara të angazhuara sipas ligjit nr 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" sipas Nenit 61/1 "Përdorim i fondeve të trashëguara nga viti i kaluar")*

- **Të shtohet Buxheti në Ndërmarrjen e Pasurisë Publike në programin AB129 në "Shërbimet Publike Komunitare" në produktin V422AAD-00-05-602 në vlerën 4,140,000 lekë.**

11. Në programin AB 129 "Shërbimet Publike Komunitare" artikulli 602 në Ndërmarjen e Pasurisë Publike të shtohet buxheti me 36,844,000 lekë për procedurë prokurimit me objekt " Blerje Gazoil dhe Benzinë gjatë vitit 2025" me kontratë me nr 1049/6 prot datë 10.12.2025 zbatimi i së cilës vijon edhe gjatë vitit 2026. Për këtë arsye kërkohet shpërndarja nga të ardhurat e trashëguara me të njëjtin destinacion me qëllim zbatimin e plotë të kontratës dhe likuidimin e detyrimeve financiare për sherbimet qe mbulojnë programi V452AAB "Rrjeti ndricimit rrugor publik urbani mirembajtur", programi V510AAB "Mirembajtja rutine e kanaleve ujites dhe kanaleve kullues", programi V510AAC "Sherbimi i stafit te menaxhimit te mbetjes dhe pastrimit" (*fonde të trasheguara të angazhuara sipas ligjit nr 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" sipas Nenit 61/1 "Përdorim i fondeve të trashëguara nga viti i kaluar")* sipas tabelës:

Kapitulli	**Programi**	**Artikulli**	Produkti	**Vlera**
01	AB129	602	V452AAB	12,165,000
01	AB129	602	V424AAB	10,052,000
01	AB129	602	V510AAB	9,102,000
01	AB129	602	V510AAC	5,525,000
	Total Gazoil			**36,844,000**

Gjithsej shtesa në buxhet, në zërin e të ardhurave të trashëguara **është 251,000,000 lekë.**

Theksojmë se Bashkia Lushnje dhe Ndërmarjet Vartëse nuk kanë detyrime të prapambetura të krijuara së fundmi. Detyrimet e prapambetura që rezultojnë të pa likujduara vinë si rezultat i mungesës së dokumentacionit për likujdim.
Ju propozojmë miratimin e shtesës së buxhetit.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

Grupi i Menaxhimit Strategjik :

Drejtoria Fianacë - Buxhetit
Ervisa Çuko

Drejtoria të Ardhurave Vendore
Donald Nushi

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave
Juljana Hasalla

Drejtoria e Shërbimit Social

Anila Çela

Drejtora e Përgj i Zhvill Urban dhe Rural
Ariola Beqo

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

Drejtoria e Burimeve Njerëzore
Erisa Qalliu

Qëndra e Arsimit
Muarrem Sharka

Ndërmarrja Pasurisë Publike
Elson Zeka

Qëndra Kulturore&Klub Shumë Sport.
Brizida Dervishi

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa: Lagja Kongresi i Lushnjes Tel: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 2707/11 Prot.

Lushnje, më 17/03/2026

PROJEKT-VENDIM Nr. 33
KËSHILLIT BASHKIAK
MBI NJË SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2026
NGA TË ARDHURAT E TRASHËGUARA
(Miratuar me VKB nr. 122 datë 23.12.2025)

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës _____ 2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë **Mbi një shtesë në Buxhetin e Vitit 2026",** mbështetur në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 54 gërma dh, në Ligjin Nr.87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", në Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, në Udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" pika 103 të ndryshuar, Udhëzimi Plotësues nr.2 datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit Viti 2026",

PROPOZOJMË:

1. Të rriten të ardhurat e trashëguara të buxhetit për vitin 2026 për vlerën **251,000,000 lekë.**
2. Të rriten shpenzimet për vitin 2026 për vlerën **251,000,000 lekë.**

Rritja do të shkojë në:

a. Në **Bashkinë Lushnje**, në programin AB 129 "Shërbimet Publike Komunitare" për **20,536,685 lekë** për objektin Rindërtim i shkollës 9 - vjeçare "Irakli Bozo" Golem" në Programin AE129-00-01-231- P912AAE.

b. Në **Bashkinë Lushnje**, në programin AB 129 "Shërbimet Publike Komunitare" për **130,000,000 lekë** për objektin "Rikalifikim i Rrugës Misto Mame" në Programin AB129-00-01-231 (kodi i projektit do të celet pasi të miratohet projekti në Këshillin Bashkiak)

c. Në **Bashkinë Lushnje**, në programin AA129 "Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse" për **3,000,000 lekë** në produktin V111AAD "Mirëmbajtja e Infrastrukturës dhe Funksionimi i Aparatit të Bashkisë" dhe V328AAC "Raste të menaxhuara të zjarrit dhe shpëtimit", nga të cilat

Adresa: Lagja Kongresi i Lushnjes Tel: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

me 2,000,000 lekë në Programin AA129-00-01-602- V111AAD dhe 1,000,000 lekë në Programin AA129-00-01-602- V328 AAC.

d. Në **Bashkinë Lushnje**, në programin AA129 "Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse" në vlerën **1,000,000 lekë** në programin AA129-00-01-231- P111AAB "Blerje Pajisje & Invest.tjera Bashkia"

e. Në **Ndërmarrjen e Pasurisë Publike**, AB129 "Shërbimet Publike Komunitare" për produktin "Rrjet Rrugor Rural i mirëmbajtur" në vlerën **20,000,000 lekë**, në produktin V452AAB-00-01-602

f. Në **Ndërmarrjen e Pasurisë Publike**, AB129 "Shërbimet Publike Komunitare" për projektin "Blerje mjeti eskavator" në vlerën **7,000,000 lekë**, në produktin P424AAB-00-01-231

g. Në **Ndërmarrjen e Pasurisë Publike**, AB129 "Shërbimet Publike Komunitare" për paga dhe sigurime për vlerën **3,179,315 lekë** në produktin "Shërbimi i stafit të ndërmarrjeve publike të gjelberimit, varrezave" V626AAA nga të cilat 679,315 lekë AB129 në produktin V626AAA-00-05 dhe 2,500,000 lekë në produktin V626AAA-00-01

h. Në **Ndërmarrjen e Pasurisë Publike**, AB129 "Shërbimet Publike Komunitare" për vlerën **3,000,000 lekë** në produktin "Rrjet Rrugor Rural i rehabilituar" V452AAC-00-01-602

i. Në **Ndërmarrjen e Pasurisë Publike**, AB129 "Shërbimet Publike Komunitare" për vlerën **22,300,000 lekë** në produktin "Rrjet Rrugor Rural i mirëmbajtur" V452AAB-00-01-602

j. Në **Ndërmarrjen e Pasurisë Publike**, AB129 "Shërbimet Publike Komunitare" për vlerën **4,140,000 lekë** në produktin "Fermerë të mbështetur për zhvillimin rural dhe bujqësor" V422AAD-00-05-602

k. Në **Ndërmarrjen e Pasurisë Publike**, AB129 "Shërbimet Publike Komunitare" për vlerën **36,844,000 lekë** nga të cilat 12,165,000 leke në produktin V452AAB -00-01-602; 10,052,000 lekë në produktin V424AAB -00-01-602; 9,102,000 lekë në produktin V510AAB-00-01-602; 5,525,000 lekë në produktin V510AAC-00-01-602.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Ndërmarrja e Pasurisë Publike, Qendra e Kulturës Klubi i futbolli, Qendra e Arsimit.

4. Vendimi hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Grupi i Menaxhimit Strategjik :

Drejtoria Fianacë - Buxhetit
Ervisa Çuko

Drejtoria të Ardhurave Vendore
Donald Nushi

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave
Juljana Hasalla

Drejtoria e Shërbimit Social

Anila Çela

Drejtora e Përgj i Zhvill Urban dhe Rural
Ariola Bego

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

Drejtoria e Burimeve Njerëzore
Erisa Qalliu

Qëndra e Arsimit
Muarrem Sharka

Ndërmarrja Pasurisë Publike
Elson Zeka

Qëndra Kulturore&Klub Shumë Sport.
Brizida Dervishi

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE